



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 154, Datë 28.05.2026

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “EZ-5 ENERGY” SH.P.K. PËR TRANSFERIMIN E PLOTË TË LICENCËS SË FURNIZIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE TE SHOQËRIA “EZ5 TRADING” SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 16 dhe 44 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 10, pikat 1 dhe 3, si dhe 17, pika 2 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19 pika 1, gërma a të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.05.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1613/1 prot., datë 26.05.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. për transferimin e plotë të licencës së tregtimit dhe asaj të furnizimit të energjisë elektrike te shoqëria “EZ5 TRADING” sh.p.k.”,

Konstatoi se:

1. Të dhëna për shoqërinë

- Shoqëria “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 439, Seria F19/F23, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 39, datë 07.03.2019, si dhe rinovuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 288, datë 09.10.2023 për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1614 prot., datë 18.05.2026, shoqëria ka depozituar aplikimin për transferimin e plotë të licencës së furnizimit të energjisë elektrike, tek shoqëria e krijuar “EZ5 TRADING” sh.p.k., e cila do të administrojë dhe operojë këtë veprimtari.

2. Përputhshmëria e Aplikimit me Rregulloren

- Në përputhje me nenin 17, pika 2 të Rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për modifikimin e licencës sipas gërmave (a, b, c, d dhe f).
- Rezulton se shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin,

njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike". Po ashtu, shoqëria ka shlyer dhe pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 17, pika 2, gërma "e", vlerësohet që t'i kërkohej shoqërisë që të bëjë sqarimet përkatëse në lidhje me kontributin financiar. Po ashtu, në referencë të këtij transferimi, shoqëria duhet të bëjë përditësimin e informacionit/dokumentacionit që ka shërbyer për licencimin e saj.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për transferimin e licencës nr. 439, Seria F19/F23, dhënë shoqërisë "EZ-5 ENERGY" sh.p.k., dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 39, datë 07.03.2019, si dhe rinovuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 288, datë 09.10.2023, për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, tek shoqëria "EZ5 TRADING" sh.p.k.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë "EZ-5 ENERGY" sh.p.k., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI